



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA SHQETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE			
DRZAVNA AGJENCIA ZA ZAŠTITU LICNIH PODATAKA			
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA			
ZYRA E ARRIVIT - KANCELARIJA ARRIVA - ARCHIVE OFFICE			
Nr. Org.	01	Nr. Prot.	57
Org. Jedin.		Br. Prot.	
Org. Unit		Prot. No.	
Nr. i faqeve	02	Data	16 04 13
Broj stranca		Datum	
No. pages		Date	20
PRISHTINË/A			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**  
**Drzavna Agjencia za Zastitu Licnih Podataka**  
**National Agency for Protection of Personal Data**

Nr. prot. 15/2013  
Datë: 16.04.2013

Në mbështetje të nenit 49 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5.) të Ligjit Nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 70/31 maj 2010) Mbikëqyrësi Shtetëror merr këtë:

**V E N D I M**

1. Këshillohet Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" që përdorimin e karakteristikave biometrike ta bëjë konform Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" deri më datë 16 Maj 2013, ta njoftojë Agjencinë për aktivitetin e kryer që ka të bëjë me zbatimin e këshillës nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimit.

**Arsyetim**

Në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 (paragrafi 1, 1.4) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejshëm LMDHP), më datë 10.04.2013, Agjencia ka realizuar inspektim të rregullt sipas detyrës zyrtare në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" në cilësinë e kontrollorit që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrimin e aktivitetit tij.

Pas inspektimit është përpiluar procesverbali me nr.11/2013, i cili është nënshkruar nga mbikëqyrësi shtetëror dhe zyrtari përgjegjës ku të njëjtit i është dorëzuar një kopje.

Në bazë të inspektimit të bërë, në procesverbal është konstatuar kjo gjendje:

Në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" bëhet përpunimi (përdorimi) i të dhënave biometrike i të gjithë të punësuarëve në aeroport. Përpunimi (përdorimi) i tyre, sipas zyrtarëve, bëhet për shkaqe të vijimit në punë dhe sigurisë në qasjen në zonat e kufizuara të sigurisë.

Aeroporti nuk i ka bërë kërkesë Agjencisë për dhënien e autorizimit për përpunimin (përdorimin) e të dhënave biometrike.

Në nenin 68 (paragrafi 1) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale parashihet që sektori privat mund të përdorë karakteristikat biometrike vetëm nëse kjo është e domosdoshme për kryerjen e aktiviteteve për sigurinë e njerëzve, për sigurimin e pronës ose për mbrojtje të të dhënave konfidenciale ose sekreteve të biznesit. Të punësuarit duhet të informohen paraprakisht në formë të shkruar për përdorimin e karakteristikave të tyre biometrike, rreth masave që do të merren dhe të drejtat e tyre.

Në nenin 68 (paragrafi 2) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale parashihet që nëse nuk është paraparë ndryshe me ligj përkatës, kontrolluesi i të dhënave duhet që para marrjes së masave për përdorimin e karakteristikave biometrike t'i ofrojë Agjencisë përshkrimin e detajuar për masat që do të merren duke përfshirë informacionet që do t'i jepen subjektit të të dhënave, arsyet për marrjen e masave dhe masat mbrojtëse për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në nenin 68 (paragrafi 3) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale parashihet që pas marrjes së informacionit nga paragrafi 2 i këtij neni, Agjencia brenda tridhjetë (30) ditësh duhet të vendosë nëse informacioni i marrë lidhur me masat është në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Në nenin 68 (paragrafi 4) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale parashihet që kontrolluesit e të dhënave mund të zbatojnë masat për përdorimin e karakteristikave biometrike, pas marrjes së autorizimit nga Agjencia.

Siç është përshkruar në arsyetimin e këtij vendimi, bazuar në nenin 49 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5.) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbikëqyrësi shtetëror ka marrë vendimin e paraqitur në dispozitiv.

#### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë, por mund të hapet konflikt administrativ në gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

#### Vendimi i dërgohet:

- Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari"
- Arkivit të Agjencisë

Adresa: Pejton Rr. Pashko Vasa Nr. 4, 10000 Prishtinë – Kosovë

Ramadan Qehaja  
Mbikëqyrës Shtetëror

